

L I G J
Nr.7818, datë 21.4.1994

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7502, DATË 25.7.1991 “PËR PARTITË POLITIKE”, NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.7591, DATË 16.7.1992

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Në ligjin nr.7502, datë 25.7.1991 “Për partitë politike”, ndryshuar me ligjin nr.7591, datë 16.7.1992, pika 3 e nenit 18 ndryshohet si vijon:

“3. Të ardhurat nga veprimtaria ekonomike e socialkulturore sipas rregullave e kritereve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave”.

Neni 2

Neni 21 ndryshohet si vijon:

“Në buxhetin vjetor të shtetit parashikohen ndihma financiare për kryerjen e veprimtarisë vjetore të partive politike.

Dhjetë për qind e këtyre ndihmave ndahen në mënyrë të barabartë ndërmjet partive politike që kanë mbi 5 mijë anëtarë, kur kjo anëtarësi është e verifikuar nëpërmjet dokumentacionit përkatës brenda tremujorit të fundit të vitit paraardhës.

Forma e verifikimit dhe dokumentacioni përkatës përcaktohet me udhëzim të veçantë nga Ministria e Drejtësisë.

Tridhjetë për qind e këtyre ndihmave ndahen në mënyrë të barabartë ndërmjet partive që në zgjedhjet parlamentare kanë fituar të drejtën të kenë grupe parlamentare, kurse pjesa tjetër ndahet në përpjesëtim me numrin e votave ndërmjet partive që kanë marrë jo më pak se dy për qind të votave”.

Neni 3

Në nenin 23, paragrafi 2 ndryshohet si vijon:

“Lejohen dhuratat dhe ndihmat kur vijnë nga parti e bashkime ndërkombëtare partish, deri në masën që nuk kalon ndihmën maksimale vjetore të dhënë nga shteti për secilën parti”.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.836, datë 5.5.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.